



CultivETing - Nxitja e sipërmarrjes në sektorin agro-ushqimor përmes Arsimit dhe Formimit Profesional

Të dashur lexues,

Ndërsa po shkojmë drejt fundit të vitit 2025, dëshirojmë t'ju përcjellim urimet tona të përzemërta. Gjithashtu, po shfrytëzojmë këtë rast për të falënderuar të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët që vazhdojnë të mbështesin dhe kontribuojnë në zbatimin e projektit *CultivETing – Nxitja e sipërmarrjes në sektorin agro-ushqimor përmes Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP)* gjatë këtij viti. Interesi, përvoja dhe angazhimi juaj kanë qenë shumë të rëndësishme për zbatimin me sukses të aktiviteteve tona.

Gjysma e dytë e vitit 2025 ka qenë dinamike, me rritje të aktiviteteve, bashkëpunimit dhe përkushtimit të gjithë organizatave partnere të projektit. Falë përpjekjeve të përbashkëta, kjo periudhë ka sjellë ecuri domethënëse, rezultate konkrete dhe përvoja të vlefshme. Këto arritje kanë forcuar më tej rolin e *CultivETing* në avancimin e inovacionit, dhe aftësive të gjelbra në AFP.

Ndërsa shikojmë përpara, mbetemi të bindur se kjo bazë e fortë do të mbështesë përpjekjet tona përgjatë vitit të ardhshëm.

Konsorciumi i CultivETing 🌱

Trajnimi i Trajnerëve: Fuqizimi i profesionistëve të AFP me aftësi të gjelbra në sektorin agro-ushqimor

Gjysma e dytë e vitit 2025 ishte e rëndësishme në zvogëlimin e hendekut midis njohurive në sistemin e AFP dhe kërkesat e tregut të punës, përmes prezantimit të programi të plotë Trajnimi të Trajnerëve (ToT). Ky program trajnimi pajisi rreth 30 mësues dhe profesionistë nga institucionet AFP në Shqipëri dhe Kosovë me aftësi të gjelbra në sektorin agro-ushqimor.


Nën drejtimin e VIS Albania, partnerët e projektit finalizuan një kurrikulë mësimore të kombinuar, që fokusohet në tre shtylla kryesore: sipërmarrjen, aftësitë digjitale dhe aftësitë e gjelbra. I bazuar në kornizat kryesore të kompetencave të Bashkimit Evropian, kurrikula ndërthur inovacionin pedagogjik me specifikat e

sistemeve gro-ushqimore. Trajnimi është i strukturuar në pesë module kryesore: digjitalizimi, aftësitë sipërmarrëse, aftësitë të gjelbra për industrinë agro-ushqimore, zhvillimi i kurrikulës, si dhe strategjitë dhe politikat.



Bazuar në ekspertizën e tyre, secili partner i projektit ka kontribuar në një modul trajnimi që trajton fusha kyçe si mësimi i bazuar në praktikë dhe sistemet ushqimore të qëndrueshme. Gjithashtu, për ta bërë përvojën e të nxëniet tërheqëse dhe efektive, u hartua një set me pyetje për vlerësimin e njohurive për secilin modul trajnimi. Për të garantuar standarde të larta arsimore, materialet iu nënshtruan një rishikimi teknik dhe një procesi bashkëpunues rishikimi nga kolegët.





Suksesi i programit të ToT qëndron tek pjesëmarrësit që do t'i përcjellin këto aftësi në klasë. Partnerët e projektit dakortësuan një proces përzgjedhjeje të bazuar në meritë për të identifikuar mësues dhe profesionistë nga shkolla të ndryshme AFP.

Si pjesë e programit u përzgjedhën individë të motivuar, me aftësi të mira komunikimi dhe interes për sektorin agro-ushqimor. Për të siguruar pjesëmarrje të gjerë dhe diversitet, u hapën dy thirrje për pjesëmarrës.

Profili profesional i pjesëmarrësve përfshinte mësues, trajnerë dhe asistentë pedagogë, si dhe role më të specializuara si ekspertë të teknologjisë ushqimore,

Pjesëmarrësit morën pjesë në një program të Trajnimit të Trajnerëve prej 14 orësh. Ky proces filloi me një takim hyrës për prezantimin e moduleve të trajnimit, i ndjekur nga sesione online të detajuara, ku pjesëmarrësit u angazhuan me detyra individuale. Në përfundim të ToT 18 pjesëmarrës u pajisën me certifikatat e pjesëmarrjes.

Vlerësimet e para nga sesionet e trajnimit ishin shumë pozitive, me pjesëmarrësit që raportuan se temat e trajtuara ishin shumë të dobishme, ku 67% u shprehën se informacioni i marrë ishte shumë i vlefshëm. Ndërkohë, cilësia e përgjithshme e trajnimit u vlerësua si shumë e mirë, me 83% të pjesëmarrësve që e vlerësuan si shkëlqyer.

Një aspekt i rëndësishëm i programit të ToT ishte përmbushja e pritshmërive të pjesëmarrësve, si në adresimin e nevojave profesionale, ashtu edhe në mundësinë për të ndjekur dhe për t'u angazhuar aktivisht gjatë sesioneve: *Trajnimi ishte i strukturuar shumë mirë, temat e trajtuara ishin të lidhura me nevojat e sektorit agro-ushqimor dhe me ndryshimet e vazhdueshme që po ndodhin në këtë sektor.*

Pjesëmarrës të tjerë theksuan aspekte pozitive të trajnimit metodologjinë dhe qasjen e trajnerit, veçanërisht balancën mes teorisë dhe praktikës, si dhe rrjetëzimin mes pjesëmarrësve: *Pikat më të forta të programit ishin qasja praktike, kombinimi i teorisë me shembuj realë dhe diskutimet aktive mes pjesëmarrësve, që duhet të ruhen edhe në të ardhmen.*

Përtej përvojës së trajnimit, pjesëmarrësit reflektuan edhe mbi mënyrën se si do ta aplikojnë njohurinë e fituar në punën e tyre të përditshme: *Njohuritë e marra do t'i zbatoj duke integruar praktikën qëndrueshme, promovuar sipërmarrjen dhe përdorur teknologjitë e reja në planifikimin e mësimin dhe aktivitetet praktike me nxënësit, për të lidhur teorinë me situata praktike në sektorin agro-ushqimor.*



Website



Facebook



Instagram



LinkedIn



Takimi i Dytë i Partnerëve të Projektit CultivETing: **Vlerësimi i progresit dhe planifikimi i hapave të ardhshëm**

Partnerët e projektit CultivETing u mbledhën në nëntor të 2025-tës në Prishtinë, Kosovë, për takimin e tyre të dytë zyrtar. I organizuar nga APPK –Agjensioni për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë, ky takim shërbeu si një moment i rëndësishëm për të reflektuar mbi arritjet e vitit të kaluar dhe për t'u koordinuar mbi hapat e ardhshëm të zbatimit të projektit.

Një moment i rëndësishëm ishte angazhimi konstruktiv me Drejtorin e Departamentit të Arsimit Profesional në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës, duke siguruar përputhje të ndërhyrjes së projektit me strategjitë kombëtare të arsimit.

Gjithashtu, partnerët përfituan nga njohja me shkollën e mesme profesionale “Abdyl Frashëri”, e cila prezantoi programin e saj të suksesshëm të studimit në Agrobiznes dhe Teknologji. Ky rast i suksesshëm tregoi për relevancën e objektivave të projektit dhe rëndësinë e lidhjes mes AFP dhe nevojave të tregut të punës në sektorin agro–ushqimor në Shqipëri dhe Kosovë.

Partnerët e Projektit

Shoqata Evropiane e Instituteve për Arsimin dhe Trajnimin Profesional (EVBB)
 VIS – Vullnetarizëm Ndërkombëtar për Zhvillim
 IEK AKMI (Greqi)
 Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural
 Agjencia për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë
 Universiteti Bujqësor i Tiranës
 BK CON
 Qendra Don Bosko
 FILSE SpA – Financiarja Liguriane për Zhvillimin Ekonomik
 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
 Rrjeti i Organizatave për Zhvillimin Rural të Kosovës.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian. Mendimet dhe opinionet e shprehura janë vetëm të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian apo të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as EACEA nuk mbajnë përgjegjësi për to.